

Vehbi Miftar



BIBLIOTEKAT
NË KOSOVË
DHE QASJA NË INFORMATA

Prishtinë, 2004

Vehbi Miftari
BIBLIOTEKAT NË KOSOVË
DHE QASJA NË INFORMATA

Vehbi Miftari

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:

Dr. Sali Bashota

Redaksia:

Dr. Sali Bashota

Dritë Deva

Fazli Gajraku

Dizajni & Realizimi kompjuterik:

Hekuran Rexhepi

© 2004, BKUK

**BIBLIOTEKAT NË KOSOVË
DHE QASJA NË INFORMATA**

Prishtinë,

2004

PËRMBAJTJA:

Hyrje.....	7
I. E drejta për qasje në informata dhe liria e të shprehurit	11
a. Të drejta të përgjithshme.....	14
b. E drejta për të marrë informata.....	16
c. E drejta për t' u shprehur.....	19
d. Komiteti <i>IFLA/FAIFE</i>	23
II. Bibliotekat në Kosovë dhe qasja e lirë në informata.....	27
III. Bibliotekat në Kosovë dhe interneti	39
IV. Përfundime.....	49
Shtojca 1:.....	55
Deklarata universale e të drejtave të njeriut.....	55
Shtojca 2:.....	69
Deklarata e Glazgout mbi bibliotekat, shërbimet e informacionit dhe lirinë intelektuale	69
Shtojca 3:.....	73
Manifesti i IFLA-s për Internetin.....	73
Shtojca 4:.....	79
Akt Mirëkuptimi (AMK)	79
Shtojca 5:.....	81
Ligji për Bibliotekat në Kosovë (Kreu VI).....	81
Bibliografia.....	91



HYRJE

E drejta për qasje të lirë në informata nënkupton jo vetëm të drejtën për të pranuar informacione, por edhe të drejtën për t'i përdorur ato si burim të përhershëm në vendimmarrje, si dhe për t'i shpërndarë ato, përmes krijimit të gjykimit të pavarur. Kështu, ajo është e ndërlidhur me të drejtën për të dhënë informata, ose me lirinë e të shprehurit. Çdo njeri duhet të jetë i lirë të shprehë mendimin e tij ose të bëjë të njohur për opinionin e tij, të cilin ai mund ta ketë marrë dhe të shtresuar përmbi argumentet vetëm nëse qasja e tij në informata ka qenë, po ashtu, e plotë. Në këtë kuptim, roli i bibliotekave në realizimin e këtyre dy segmenteve të së drejtës së individit, janë të një rëndësie të veçantë. Ato mund të ndihmojnë

në krijimin e mundësive për edukim të mirë dhe për vendimarrje të pavarur. Përmes edukimit gjatë tërë jetës ato ndikojnë në edukimin e shoqërisë dhe ndihmojnë ngritjen e ndërgjegjes për lirinë e individit, sidomos për të drejtën e tij për të shprehur i lirë mendimin e vet.

Të gjitha qeniet njerëzore, pa përjashtim, duhet ta gëzojnë të drejtën për të pasur qasje në të gjitha sferat e dijës, në aktivitetin kreativ dhe atë intelektual, si dhe që t'i shprehin haptas mendimet e tyre. Asnjë kufizim në qasjen e lirë në informata nuk mund të bëhet për shkak të mospëlqimit ndaj ideve të tjetrit ose për shkaqe të tjera, duke përfshirë racën ose gjininë.

E drejta për të marrë informata dhe liria e të shprehurit janë dy aspekte të të njëjtit parim. Liria e shprehjes realizohet duke e ruajtur të drejtën për të pranuar informata. E drejta për të ditur është e lidhur ngusht me lirinë e mendimit, më ndërgjegjen dhe me të drejtat e tjera themelore njerëzore. Liria e të menduarit dhe liria e shprehjes janë parakushte të domosdoshme për lirinë e qasjes në informata, ndërsa vendimarrja duhet të realizohet si e drejtë e individit për të vendosur vetë, në mënyrë të pavarur, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me të tashmen ose me perspektivën e individit ose të tërë shoqërisë, pa pasur presione ose kufizime në tërë procesin e vendimarrjes. Për këtë arsye, shoqëria duhet të garantojë ofrimin e menjëhershëm dhe të pakufizuar në informata, në mënyrë që individit të krijojë opinionin e tij të pavarur, kurse gjykimi i

tij për çështje të caktuara të jetë i bazuar në argumente faktike. Kësisoj, ai do të marrë vendime, të cilat ndonjëherë janë jetike për gjithë shoqërinë, i sigurt se vendimi i tij ka rrjedhur si logjikë e shqyrtimit të vazhdueshëm të argumenteve, e si kurorëzim i reflektimit për to. Bibliotekat, sidomos ato publike, kanë detyrim që t'ia ofrojnë secilit këto informata, në mënyrë që vendimet e atij që merr këto informata, t'i shërbejnë prosperimit të gjithë shoqërisë. Sot, vendimarrja e lirë dhe moskufizimi i qasjes në informata janë të lidhura ngusht në mes veti, kështu që shoqëritë e stabilizuara hartojnë programe të veçanta për realizimin e kësaj të drejte, me synimin që të krijohet një shoqëri kohezive dhe të instalohet një demokraci e mirëfilltë.

Por, cili ka qenë roli i bibliotekave në Kosovë në ngritjen e kapaciteteve hulumtuese në mbrojtjen e të drejtës themelore të individit për qasje të lirë? Sa kanë ndikuar ato në vetëdijësimin e stafit bibliotekar, po edhe në edukimin e qytetarëve, për rëndësinë që ka mbrojtja e të drejtës për qasje të lirë në informata? Si është realizuar kjo e drejtë? Cilat janë parimet themelore të cilat një bibliotekë duhet t'i përmbushë për këtë qëllim?

Në pjesën e parë, ky libër synon të japë përgjigje teorike në disa pyetje, duke u mbështetur përmbi një dije, të praktikuar nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë. Kësisoj, në kapitullin e parë të tij i kam përfolur disa nga parimet themelore të IFLA-s dhe të organizmave të tjerë, duke u fokusuar në të drejtat dhe

liritë intelektuale në botë.

Në kapitullin e dytë jam përpjekur që këto parime t'i vështroj përbrenda praktikës bibliotekare në Kosovë.

Në kapitullin e tretë kam shqyrtuar raportin e bibliotekave karshi teknologjive të reja informative, si dhe rolin e tyre në përparimin e shërbimeve bibliotekare në varshmëri me zhvillimin e këtyre teknologjive.

Në pjesën e dytë të librit janë ofruar për lexim disa nga parimet themelore të IFLA-s, si dhe dokumente të tjera, duke përfshirë këtu edhe Ligjin mbi Bibliotekat, kreun që ka të bëjë me Bibliotekën Kombëtare dhe me Bibliotekën Universitare, si dhe me bibliotekat publike në Kosovë, me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme për mënyrën e rregullimit dhe të praktikës së punës në biblioteka, dhe për t'i ofruar mundësi lexuesit që të krijojë një vizion të përafërt se si mund të përparohen shërbimet bibliotekare, me qëllim të realizimit të të drejtave themelore të përdoruesve për të qenë të lirë për të pranuar informata.

Prishtinë,
gusht - shtator 2004

I. E DREJTA PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA DHE LIRIA E TË SHPREHURIT

E drejta për qasje të lirë në informata dhe e drejta për t'i shprehur në mënyrë të pavarur dhe krejtësisht lirshëm mendimet, është e drejtë themelore e secilit individ. Ajo është e garantuar me konventa ndërkombëtare. Dokumenti i parë i rëndësishëm, i cili parashihte mbrojtjen e kësaj të drejte, është *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara* (shih shtojcën 1), e miratuar në dhjetor të vitit 1948. Kjo deklaratë, sidomos neni 19 i saj, parashohin të drejtën e individit për të qenë i pavarur në mënyrën e të gjykuar-

it dhe në krijimin e opinionit, si dhe të drejtën elementare të tij për qasje të lirë në informata.

Neni 19 i *Deklaratës...* thotë:

Çdo njeri ka të drejtë në lirinë e mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të ruajtur mendime pa interferenca dhe të kërkojë, të krijojë dhe të kumtojë informata dhe ide përmes çfarëdo mediami dhe pa marrë parasysh kufijtë.

Kjo deklaratë e mbron dhe e promovon të drejtën e secilit individ, por edhe të të gjithëve së bashku, për të pasur të drejtë qasjeje në informata dhe për të pasur, po ashtu të drejtë, për t'u shprehur lirshëm dhe pa asnjë pengesë. Liria e individit dhe e komunitetit për të krijuar ose për të shpërndarë informacione është e drejtë e garantuar me këtë Deklaratë.

Në kuptimin e krijimit të mekanizimit për mbrojtjen e këtyre të drejtave të individit, opinioni bibliotekar u sensibilizua për herë të parë më 1997, kur u miratua Deklarata e Glazgout (shih shtojcën 2, *Deklarata e Glazgout mbi bibliotekat, shërbimet e informacionit dhe lirinë intelektuale*), me rastin e 75-vjetorit të formimit të Federatës Ndërkombëtare të Asociacioneve dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA). Me këtë deklaratë IFLA shpalli të drejtën fundamentale të qenieve njerëzore për qasje dhe shprehje

të informacionit pa kufizim dhe konfirmoi se stafi bibliotekar dhe shërbimet e informacionit do të ofrojnë qasje në informacion, pa marr parasysh kufijtë. Ajo shpalli se bibliotekat do të mbledhin, do të ruajnë dhe do të ofrojnë shumëllojshmëri të gjerë materialesh, duke reflektuar kështu pluralitetin dhe diversitetin në shoqëri.

Pas miratimit të kësaj deklaratë, roli dhe përgjegjësitë e bibliotekave në promovimin e lirisë së individit për të zhvilluar aktivitetet për pavarur intelektual, u rritën dukshëm. Bibliotekat gradualisht u shndërruan në realizues dhe monitorues të lirisë intelektuale.

Më 1997 u themelua Komiteti i IFLA-s për Lirinë e



Postkartë me nenin 19 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, e aprovuar nga Komiteti i IFLA/ FAIFE-s.

Qasjes së Informata dhe Lirinë e Shprehjes, FAIFE, i cili i mbron dhe i promovon këto të drejta brenda opinionit bibliotekar në mbarë botën. Ky komitet aprovoi nënin 19 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dokument bazë, mbi të cilin do të mbrojtë dhe do të promovojë të drejtën për qasje të lirë dhe lirinë e të shprehurit.

Qëllimi i formimit të këtij komiteti ishte jo vetëm përcaktimi i përgjegjësisë të stafit bibliotekar për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të informatave, ose krijimi i parakushteve për individin që të zhvillojë aktivitet të pavarur intelektual e të shprehë mendimin e tij të pavarur, por që të ndikojë edhe në stimulimin e vendimmarrjes së lirë, në mbrojtjen dhe promovimin e së drejtës së individit për qasje të lirë në informata dhe për shprehje të lirë, si themel për funksionim të mirëfilltë të demokracisë. *E drejta e individit* për të mbajtur dhe për të shprehur i lirë mendimet e tij është esenciale për instalimin e shërbimeve cilësore profesionale nëpër biblioteka, prandaj realizimi i këtyre lirive është çelës për suksesin e vetë bibliotekave.

a. Të drejta të përgjithshme

Shërbimet e mira dhe cilësore bibliotekare formojnë një komponentë themelore për qasje të

përgjithshme. Përmes krijimit të mundësive për qasje të lirë në informata, bibliotekat e ndihmojnë ndërtimin e shoqërisë përmbi një sistem vlerash. Duke qenë të lirë për të thithur ose për të shpërndarë informata, secili njeri, por edhe të gjithë bashkë, janë të lirë për të krijuar gjykimin e tyre të pavarur për një çështje, e me këtë e ndihmojnë procesin e vendimmarrjes së lirë, që është jetike për shoqëritë e konsoliduara. Diskutimet në shoqëritë e stabilizuara, prandaj, janë të lira dhe të hapura ndaj ideve. Bibliotekat publike kanë përgjegjësi për të organizuar takime në të cilat do të diskutohen çështje të caktuara, sidomos përsa i përket afirmimit të kulturës së komuniteteve dhe edukimit të tyre. Kësisoj, ato shndërrohen jo vetëm në qendra të edukimit, por edhe të kulturës, në të cilën të gjithë qytetarët pa përjashtim do të kenë mundësi të diskutojnë dhe të njihen me kulturën e tjetrit, si dhe të kërkojnë mundësi për gjetjen e informatave të nevojshme për ta, por edhe të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare.

Bibliotekat dhe stafi bibliotekar duhet të aderojnë fuqimisht në parimet themelore të lirisë intelektuale, për t'i njohur të drejtat e përdoruesve, në mënyrë që shërbimet të cilat i ofron biblioteka të përmbushin kërkesat themelore të përdoruesve për qasje të papen-

guar në të gjitha sferat e dijës dhe të kulturës.

Bibliotekat, si institucione publike që kanë për detyrë të marrin pjesë në edukimin e njerëzve dhe në krijimin e shoqërisë kohezive, duhet të garantojnë krijimin e mundësive për qasje në të gjitha sferat e dijës. Po ashtu, bibliotekat mund të luajnë rol të rëndësishëm në ofrimin e qasjes në aktivitetet kreative dhe intelektuale. Liria intelektuale nënkupton qasjen në këto sfera të dijës njerëzore. Secili individ i cili u drejtohet bibliotekave të cilat financohen me mjete publike buxhetore janë të lirë të kërkojnë plotësimin e kërkesave të tyre për të marrë informata, për të shfrytëzuar literaturën e nevojshme, si dhe për të marrë shërbime cilësore bibliotekare. Përdoruesit e bibliotekave duhet të ndjehen të lirë të krijojnë në mënyrë krejtësisht të pavarur opinionin e tyre për çdo çështje që ka të bëjë me të tashmen ose me të ardhmen e tyre. E, ofrimi i mundësive për të krijuar dhe për të mbajtur opinion të pavarur nënkupton edhe lirinë e shprehjes. Secili individ duhet të ndjehet i lirë për t'u shprehur për të gjitha çështjet.

b. E drejta për të marrë informata

E drejta për të marrë informata është e drejtë e garantuar për secilin njeri. Ajo është jetike për çdo

shoqëri. Individët duhet të kenë qasje të lirë në të gjitha format e informatave, pa kushtëzime dhe pa marrë parasysh kufijtë. Shoqëria duhet që atyre t'u krijojë qasje në të gjitha llojet e informatave, qofshin ato informata politike, sociale, shkencore ose ekonomike, si dhe qasje të lirë në shprehitë kulturore. Kjo ndikon në krijimin e predispozitave që ata të vendosin për informatat që do t'i zgjedhin. Zgjedhja e informatave duhet të jetë çështje e interesit individual dhe bibliotekat kanë për detyrë që këto materiale të zgjedhura t'ua ofrojnë përdoruesve të tyre. Madje, bibliotekat duhet që, jo vetëm t'u krijojnë individëve mundësi qasjeje në informata, të cilat i zgjedhin, por të përpiqen që këtë qasje t'ua ofrojnë edhe në rendin e ideve, të informatave dhe të imazheve (përfytyrimeve). Liria, prosperiteti dhe zhvillimi i një shoqërie varet nga edukimi dhe krijimi i mundësive për qasje të pakufizuar në dije, kulturë dhe informacione.

Por, bibliotekat kanë për detyrë që jo vetëm të krijojnë qasje të lirë në të gjitha llojet e informatave, por, njëkohësisht, ato duhet të stimulojnë edhe mundësinë e realizimit të kësaj të drejte për të gjithë individët, sidomos për grupet e vogla, të cilat nuk kanë çdo herë mundësi që t'i realizojnë kërkesat e tyre themelore përmes informacioneve të cilat janë, kryesisht, në shërbim të shumicës. Në këtë aspekt, bibliotekat mund dhe duhet të planifikojnë

jnë mirë politikat e tyre të pasurimit të koleksioneve bibliotekare, në mënyrë që fondet e tyre të reprezentojnë diversitetin e kulturave, si dhe të përmbushin kërkesat e grupeve të ndryshme sociale për të marrë informata. Ta zëmë, bibliotekat kanë mundësi që përmes huazimit ndërbibliotekar të sigurojnë materiale të vlefshme për kulturën e të gjitha grupeve etnike ose sociale, si dhe materiale gjuhësore, në mënyrë që këto grupe (të hendikepuarit ose të verbërit, etj.) të kenë mundësi qasjeje në informacione edhe në rastet kur bibliotekat nuk i kanë këto materiale në fondet e tyre. Përfaqësimi i kulturës lokale, qoftë përmes realizimit të së drejtës së qytetarëve për qasje të drejtpërdrejtë në materialet e bibliotekës, qoftë përmes propagandimit të kulturës së tyre përmes ekspozitave, promovimeve, takimeve me krijues etj., është esencial për ruajtjen e kontaktit me përdoruesit. Prandaj, realizimi i kësaj të drejte nga ana e bibliotekave jo vetëm që është jetik për funksionimin e një biblioteke, por edhe indikacion shumë i rëndësishëm për të vlerësuar progresin e demokracisë së një vendi. Ajo prezanton nivelin e përfaqësimit të ideve në shoqëri, si dhe rolin e individit në vendimmarrje të lirë e të pakushtëzuar, si e drejtë e cila ndikon shumëfish në nivelin e zhvillimit të demokracisë, madje është një prej parametrave më të përsosur për matjen e këtij niveli. Në disa vende të zhvilluara, e drejta për të marrë informata

është e rregulluar me *Ligjin për Lirinë e Informacionit*,¹ me të cilin përcaktohen të drejtat e çdo qytetari për të marrë informacione.

c. E drejta për t'u shprehur

Nga niveli i ofrimit të shërbimeve varet se si individ do ta zhvillojë mënyrën e tij të krijimit të gjykimit të lirë dhe të pavarur. Kjo nënkupton që bibliotekat, përmes edukimit gjatë tërë jetës, mund të ndikojnë edhe në formën e të shprehurit të lirë të mendimeve të individëve. Secili qytetar ka të drejtë që, në bazë të informatave që i posedon, të krijojë mendimin e tij të pavarur, por ai ka po ashtu të drejtë që këtë vendim ta shprehë lirshëm. Kështu, bibliotekat ndikojnë në *zhvillimin kulturor* të individëve dhe në krijimin e mundësive për vendimmarrje të lirë.

E drejta për t'i shprehur mendimet lirshëm dhe pa asnjë pengesë nuk nënkupton në asnjë mënyrë që individ nuk duhet ta respektojë, po ashtu, të drejtën e tjetrit për të shprehur lirshëm mendimin e tij, ose që nuk duhet respektuar atë mendim. Në këtë kuptim, bibliotekat në vendet e qytetëruara njihen jo vetëm si qen-

¹ Shërbimet e bibliotekës publike, udhëzime të IFLA/UNESCO-s për zhvillim, Tiranë, 2002

dra të edukimit të shoqërisë, por edhe si *qendra kulturore*, sepse përmes krijimit të mundësive për diskutime për çështje të caktuara ato e ngrisin *nivelin kulturor* dhe ndihmojnë në zhvillimin e dialogut mes qytetarëve. Në Kosovë, një formë e tillë është pothuajse e panjohur. Vetëm viteve të fundit në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës është iniciuar një formë e diskutimeve për çështje që kanë të bëjnë me kulturën ose qytetërimin shqiptar, pa përfshijtur edhe diskutime të karakterit politik e edukativ.

Bibliotekat i mbledhin, i ruajnë dhe i koleksionojnë materialet bibliotekare, në forma të ndryshme, me qëllim të krijimit të *pasqyrës përmbledhëse për trashëgiminë kulturore* të një vendi. Përmes ofrimit të këtyre materialeve bibliotekare, shumica e të cilave janë vepra krijuese, ato realizojnë të drejtën e secilit për të patur qasje jo vetëm në aktivitetin kreativ, por edhe në idetë e kohës, të sotme ose të mëhershme. Përmes njohjes me veprat krijuese, përdoruesit e bibliotekave e realizojnë njohjen jo vetëm me idetë, por edhe me kulturën e tyre ose me kulturat e tjera, si dhe me mendimet kryesore të kohës, prandaj ofrimi i shërbimeve cilësore bibliotekare mundëson krijimin e një shoqërie të vetëdijshme e të edukuar, e cila njohjen me kulturën(at) e shndërron në përvojë për zhvillimin e kulturës individuale ose kolektive. Ato shërbejnë si

portë hyrëse në mendim dhe kulturë.

Këto të drejta duhet të jenë të garantuara *për të gjitha kategoritë e shoqërisë*. Bibliotekat janë të detyruara që t'ju ofrojnë shërbime si dhe që ta adaptojnë hapësirën për shfrytëzimin e materialeve për këto kategori. Bibliotekat kanë përgjegjësi për të siguruar ruajtjen dhe përdorimin e tipeve të ndryshme të materialeve, duke e pasqyruar shumësinë dhe diversitetin e shoqërisë. Ruajtja e këtyre materialeve, përzgjedhja e tyre, si dhe krijimi i kushteve për përdorim të materialeve bibliotekare dhe të shërbimeve bibliotekare është përgjegjësi profesionale e stafit bibliotekar. Ky staf duhet të udhëhiqet nga vetëdija e lartë profesionale. Ai duhet ta ketë vazhdimisht parasysh se e drejta për të marrë informata është pjesë e lirive njerëzore. Bibliotekat duhet t'ua ofrojnë materialet, pajisjet dhe shërbimet e veta të gjithë përdoruesve. Nuk guxon të ketë diskriminim racor, diskriminim për shkak të besimit, gjinisë, moshës ose për ndonjë arsye tjetër. Çfarëdo ndikimi në punën e stafit bibliotekar, përvëç përgjegjësisë profesionale, është i dëmshëm. Ndikimet politike, moralizuese ose fetare duhet të shmangen nga praktika bibliotekare. Bibliotekat kanë për obligim që të mbledhin, të organizojnë dhe të shpërndajnë informacione, lirshëm dhe t'i kundërvi-

hen çdo lloj forme të censurës. Individëve ose grupeve duhet t'u ofrohet mundësi qasjeje në të gjitha dokumentat të cilat i shërbejnë edukimit të tyre individual ose kolektiv,

Po ashtu, bibliotekat duhet të sigurojnë mbështetje të vazhdueshme për *mësimin gjatë tërë jetës* (lifelong learning) për kategori të caktuara të shoqërisë. Pas formimit të Qeverisë së Kosovës, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, janë themeluar sektore të veçanta për mësimin gjatë jetës (mësimin joformal). Bibliotekat mund të luajnë një rol me rëndësi në zbatimin praktik të kësaj strategjie.

Duke ofruar qasje të lirë në informata, qasje të lirë në internet (shih shtojcën 3: *Manifesti i FLA-s për Internetin*), të vendimmarrjes së lirë, si dhe lirinë e shprehjes e mësimin gjatë jetës, bibliotekat ndikojnë në zhvillimin dhe përkrahjen e lirisë intelektuale dhe ndihmojnë në ruajtjen e vlerave themelore demokratike. Duke i zbatuar këto standarde, shoqëria ndërton një demokraci të brendshme, e cila ruan dhe promovon vazhdimisht lirinë e individit. Po ashtu, përmes krijimit të mundësiave për qasje të lirë dhe për mësim të vazhdueshëm, bibliotekat promovojnë vazhdimisht të drejtat civile universale. Në këtë mënyrë, ato shndërrohen në qendra kulturore, promo-

tore të lirive individuale dhe të ruajtjes e të promovimit të vazhdueshëm të lirive qytetare, të parapara me Deklaratën Universale të KB-ve, sidomos me nenin 19 të saj.

Një segment i veçantë i ndërtimit të parimeve bibliotekare në raport me përdoruesit e tyre, si dhe me të drejtën e tyre për t'u qasur në informata, është raporti i *përgjegjësiave të stafit bibliotekar karshi përdoruesve të bibliotekës*, në njërën anë, dhe punëdhënësve të tyre, në anën tjetër. Mbrojtja e të drejtave të përdoruesve është vendimtare për krijimin e raporteve të shëndosha në shoqëri. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre dy përgjegjësiave, përgjegjësitë e bibliotekarëve para përdoruesve duhet të kenë përparësi.

d. Komiteti IFLA/FAIFE

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve për qasje të lirë në informata, si dhe për të mbrojtur e promovuar lirinë e shprehjes, më 1997 u themelua Komiteti për Qasje të Lirë në Informata dhe Lirinë e Shprehjes, FAIFE, njëri ndër komitetet më të rëndësishme të Federatës Ndërkombëtare të Asociacioneve dhe Institucioneve Bibliotekare, (International

Federation of Library Association and Institutions), IFLA. FAIFE synonte mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore njerëzore, të parapara në nenin 19 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, të miratuar në dhjetor të vitit 1948.

Komiteti IFLA/FAIFE e stimulon lirinë e qasjes në informata dhe lirinë e shprehjes në të gjitha aspektet, të cilat në çfarëdo forme janë të lidhura me bibliotekat ose me komunitetin bibliotekar; e monitoron gjendjen e lirive intelektuale brenda komunitetit bibliotekar në të gjithë botën; i mbështet politikat e IFLA-s për krijimin ose thellimin e bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; si dhe përpiqet t'i japë përgjigje shkeljes së të drejtave të përdoruesve. Këto qëllime FAIFE synon t'i realizojë duke pasur parasyh disa parime themelore që kanë të bëjnë me lirinë intelektuale, siç janë:

- *Liria intelektuale nënkupton të drejtën e çdo individ që të mbajë dhe të shprehë mendimin e tij, si dhe të japë ose të pranohë informata;*
- *liria intelektuale është bazë e demokracisë dhe*
- *Liria intelektuale është themel i konceptit bibliotekar.*

Objektiv i përgjithshëm i komitetit është *ta ngrisë nivelin e ndërgjegjes për ndërlidhjen ndërmjet konceptit bibliotekar dhe vlerave të lirisë*. Për ta arritur këtë

qëllim, FAIFE mbledh dhe shpërndan dokumente dhe synon ta stimulojë dialogun brenda dhe jashtë komunitetit bibliotekar. Rrjeti i krijuar ndërmjet kolegëve, kontaktet mediale, aktivitetet për të drejtat njerëzore etj., janë pjesë e punës së komitetit FAIFE.

Ambicja e këtij komiteti është të veprojë si pikë fokalizuese për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lirinë intelektuale, me bibliotekat dhe me bibliotekarinë përgjithësisht.

FAIFE mirëmban shërbimin e dhënies së informatave në internet dhe përpilon raportin vjetor, për përdorim publik, për gjendjen në qasje të lirë dhe lirinë e të shprehurit brenda komunitetit bibliotekar botëror; sugjeron dhe promovon politikat e përgjithshme në fushë të lirisë intelektuale. Ajo i propozon IFLA-s programin dhe i ekzekuton veprimet e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; jep përgjigje ndaj shkeljeve të së drejtës për qasje të lirë dhe të lirisë së shprehjes, duke ndikuar te bibliotekat dhe bibliotekarët. Ajo parasheh, po ashtu, edhe këshilla dhe mbështetje konkrete për bibliotekarët, bibliotekat ose shoqatat bibliotekare nëse ato e kërkojnë këtë gjë prej saj; bashkëpunon me organizmat ndërkombëtare, të cilat ndihmojnë në organizimin e fushatave, siç janë UNESCO, PEN-i ndërkombëtar, IFEX-i dhe Amnesty International.

Plani strategjik i komitetit FAIFE për vitin 2004-2005 është përqendruar në tri fusha – çelës. Ato janë:

- *mbrojtja,*
- *edukimi dhe*
- *intervenimi.*

Brenda këtyre tri fushave do të identifikohen dhe do të ndërmerren veprimet e nevojshme, siç janë: *thelimi dhe monitorimi i kapaciteteve hulumtuese dhe projektet kërkimore të bibliotekave.*

Këto kapacitete do të sigurojnë paraprakisht informata të rëndësishme për bibliotekat; vetëm një pjesë e vogël e informatave për incidentet eventuale nëpër biblioteka arrin të ne nga vendet në të cilat janë të dukshme shkeljet e të drejtave njerëzore dhe të lirisë intelektuale, duke përfshirë edhe lirinë e qasjes së lirë në informata.

Hartimi i një manuali do të synojë të japë përgjigje më të qartë kundër shkeljes së të drejtave dhe lirive elementare nëpër bibliotekat publike në botë.

II. BIBLIOTEKAT NË KOSOVË DHE QASJA NË INFORMATA

Një kohë të gjatë bibliotekat në Kosovë e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në varshmëri nga zhvillimet politike. Jo rralë materialet bibliotekare janë ruajtur ose janë shkatërruar si pasojë e këtyre ndikimeve. Shkëputjet në punën e bibliotekarëve kanë qenë të pashmangshme. Shumë materiale me vlerë, sidomos gjatë kohës së administrimit të bibliotekave nga ish-regjimi serb në Kosovë janë zhdukur ose dëmtuar. Të tjera thuhet se vazhdojnë të jenë të rrezikuara, si pasojë e pamundësisë së aplikimit të standardeve ndërkombëtare për ruajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Krijimi i rrjetit të bibliotekave në Kosovë, i paraparë me *Ligjin për Bibliotekat*, i cili është aprovuar në Kuvendin e Kosovës në qershor të vitit 2003, krijon mundësi të kërkimit elektronik në bazën e të dhënave (database) në të gjitha bibliotekat e Kosovës. Përdoruesit e bibliotekës në cilindo qytet të Kosovës do të kenë mundësinë që jo vetëm të marrin informata për ndonjë material bibliotekar, i cili mund të gjendet në një bibliotekë tjetër në Kosovë, por që, përmes formës së *Huazimit Kombëtar Bibliotekar*, ta sigurojnë atë material në bibliotekën e tyre. Po kështu, ata do të kenë mundësi që nga biblioteka e tyre (ose, nga shtëpia) të marrin informacion në cilëndo nga bibliotekat kombëtare të botës (përmes sistemit të automatizuar), si dhe të huazojnë materiale përmes Bibliotekës Kombëtare të Kosovës (e cila luan rolin qendror në sistemin e huazimit ndërkombëtar përmes Ligjit Ndërkombëtar të Huazimit - *International Library Loan*).

Krijimi i Rrjetit të Bibliotekave nënkupton krijimin e katalogut të përgjithshëm elektronik të të dhënave të bibliotekave të Kosovës, përmes programit të automatizuar. Sipas Ligjit për Bibliotekat, Biblioteka Kombëtare e Kosovës do të shërbejë si *qendër* e rrjetit të përgjithshëm të bibliotekave në Kosovë. Kjo nënkupton që baza e të dhënave (database), e instaluar në këtë bibliotekë do të përfshijë të gjitha të dhënat, në formë elektronike, të fondevë në bibliotekat e Kosovës, të cilat do të inkorporohen në rrjet.

Katalogu i përgjithshëm elektronik është i domosdoshëm për ofrimin e plotë dhe të pakushtëzuar të informatave. Deri tash, në Kosovë ka munguar forma e tillë e ofrimit të informatave. Në vitet '80, në ish-Jugosllavi ka filluar përpunimi elektronik i të dhënave në bibliotekat në ish entitetet administrative të saj, përmes sistemit COBISS dhe COBISS 1 (sot, kjo bazë ruhet në Maribor- Slloveni), por për shkak të ndryshimeve politike, ky proces nuk është përfunduar. Mungesa e një katalogu të tillë e ka reduktuar tej mase mundësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore bibliotekare. Si mund të imagjinohet sot kërkimi i një lloji të literaturës pa katalogun elektronik të të dhënave? Vetë stafi bibliotekar nuk është në gjendje të ofrojë të dhëna të sakta për fondet e bibliotekës, sepse mundësia e hulumtimit të tyre është e pamundur me skedarin- letër.

Stafi bibliotekar, i cili ka punuar para viteve '90 nëpër bibliotekat e Kosovës ka qenë kryesisht staf me përgatitje të tjera profesionale. Sipas një hulumtimi të vitit 2003, të bërë nga Departamenti për Hulumtim dhe Zhvillim Bibliotekar i BKUK-së, vetëm 35 punëtorë të bibliotekave publike në tërë Kosovën kanë të kryer ndonjërin nga fakultetet(!), ndërkohë që nuk dihet saktësisht se sa prej tyre i janë nënshtruar provimit kualifikues për bibliotekar, i cili ka ekzistuar më herët në ish- Jugosllavi, kurse në Kosovë ai ka filluar të mbahet në vitin 1983 dhe ka zgjatuar deri më 1989,

BIBLIOTEKAT NË KOSOVË

kur ka filluar përjashtimi i shqiptarëve nga institucionet.

Sipas Ligjit të vjetër për Bibliotekat, i cili është miratuar më 1979, punëtorët e bibliotekave i janë nënshtruar *provimit kualifikues*, i cili është mbajtur në Bibliotekën Kombëtare (atëherë Biblioteka Popullore), por një formë e organizuar e shkollimit në Kosovë ka munguar.

Në vitet '60 disa breza nxënësish kanë pasur mundësi që të kryejnë shkollimin e mesëm për bibliotekarë, meqë në vitin shkollor 1966/67 në kuadër të Universitetit të Punëtorëve u hap Shkolla e Mesme e Bibliotekave, e cila megjithatë ishte e mangët, sepse stafi i saj ishte po ashtu i pakualifikuar. Nga kjo shkollë kanë dalë disa breza nxënësish, mirëpo shkollim të mirëfilltë profesional nuk ka pasur. Në vitet '90, në kohën kur teknologjitet e reja informative u futën në biblioteka dhe kur koncepti për shërbimet bibliotekare në botë u ndryshua rrënjësisht, pjesa dërmuese e punëtorëve shqiptarë u larguan nga bibliotekat, kurse studentët dhe përdoruesit e tjerë shqiptarë nuk u lejuan të kenë qasje në materialet bibliotekare!

Rrjedhimisht, metodat të cilat sot ky staf i njej dhe i aplikon në Kosovë janë të para viteve '90, ndërkohë që koncepti për bibliotekat ka evoluar shumëfish. Me rikthimin e tyre në biblioteka, ata nuk i janë nënshtruar trajnimeve shtesë, për shkak të mungesës së programeve të trajnimit ose të fondeve

DHE QASIA NË INFORMATA

Komuna	Fakultet	Shkollë e lartë	E mesme	Gjithsej
Deçani	1	-	2	3
Malisheva	2	-	1	3
Vushtrri	-	-	7	7
Therandë	4	1	-	5
Sharri	1	-	4	5
Prishtinë	7	3	15	25
Mitrovicë	1	-	10	11
Gjakovë	2	4	1	7
Gjilan	4	4	7	15
Viti	1	1	5	7
Klinë	1	2	-	
Drenas	-	1	2	3
Besianë	-	3	2	5
Skënderaj	-	-	4	4
Burim	3	-	-	3
Rahovec	-	1	1	2
Prizren	2	4	5	11
Kastriot	-	1	4	5
Lypjan	-	-	8	8
Pejë	2	-	5	7
F-Kosovë	2	2	1	5
Ferizaj	1	-	6	
Kaçanik	-	1	3	4
Shtime	1	-	-	1
Dardanë	-	1	4	5
Artanë	-	-	3	3
Gjithsej	35	29	100	164

Numri i stafit bibliotekar në bibliotekat publike sipas përgatitjes arsimore (më 2003).

buxhetore. Stafit i ri, i cili është pranuar pas vitit 1999, por që përbën një përqindje më të vogël, është pothuajse i paformuar profesionalisht. Në mungesë të programeve për formim bibliotekar (*Ligji për Bibliotekat* është aprovuar tek më 2003, kurse Ministria e Kulturës ende nuk ka nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore, siç parashihet me ligj), ata u janë nënshtruar vetëm trajnimeve sporadike. Vështirësitë në ofrimin e shërbimeve cilësore bibliotekare për përdoruesit janë ndonjëherë pasojë e pamundësisë për t'i përafuar këto dy shtresa të stafit bibliotekar në kuptimin e aplikimit të standardeve ndërkombëtare, të aplikueshme në bibliotekat e shumicës së vendeve të botës. Plotësimi i nevojave për trajnime të stafit bibliotekar nuk është i kënaqshëm.

Pas vitit 1999, shqiptarët u kthyen në vendet e tyre të punës, por, në ndërkohë, zhvillimi i teknologjive të reja kishte ndryshuar shumëçka në konceptin për bibliotekat, kështu që njohuritë ekzistuese të stafit bibliotekar duhej të përplotësoheshin me njohuri të reja për standardet e aplikueshme dhe sidomos për përdorimin e teknologjive të reja informative në biblioteka dhe për ndikimin e tyre në përmirësimin e shërbimeve bibliotekare. Kjo nuk qe e mundur edhe për shkak të pamundësisë që bibliotekat të organizojnë trajnim për aftësimin e stafit për përdorimin e këtyre

teknologjive. Në ndërkohë, shumë biblioteka pranuan staf të ri, i cili kishte përgatitje tejet heterogjene. Meqë ishin të pakualifikuar në fushë të bibliotekarisë, supozohej se ky staf i ri, i cili kishte disa njohuri për përdorimin e teknologjive të reja, por i mungonte vizioni për aplikueshmërinë e tyre në biblioteka, do t'i nënshtronte trajnimeve profesionale. Sot, bibliotekat në Kosovë vazhdojnë të kenë një staf të vjetër bibliotekar dhe një staf të ri, të patrajnuar, prandaj organizimi i shërbimeve bibliotekare vazhdon të jetë sfidë për të gjitha bibliotekat në Kosovë. Nuk dihet saktësisht se cili është niveli i njohjes së përdorimit të teknologjive të reja informative. Asnjë analizë e tipit SWOT nuk është bërë nga stafi menaxhues i bibliotekave në Kosovë. Madje, krijohet përshtypja se asnjëri syresh nuk nje praktikisht sistemin e analizave të tipit SWOT ose PESTL.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, e cila me Ligjin e ri për Bibliotekat është qendër e trajnimeve profesionale për gjithë stafin bibliotekar në Kosovë, ende nuk e ka marrë këtë përgjegjësi. Trajnimet kanë qenë më shumë të tipit sporadik, pa ndonjë program të veçantë dhe pa synime të caktuara.

Bibliotekat kanë qasje të kufizuar në internet.

Projekti SKIT nuk i ka përfshirë shumicën e komunave të Kosovës, kurse disa biblioteka ndërkomunale kanë përfi-

TRAJNIMET E MBAJTURA GJATË

PERIUDHËS 1999-2004

Biblioteka	Nr. i stafit	Nr. i trajnimeve	Traj. i fundit (vendi dhe koha)
BKUK	105	8	Tiranë, 2004
Prishtina	38	5	BKUK
Mitrovica	18		
Gjilani	27	6	BKUK
Peja	14	3	BKUK
Gjakova	12	1	BKUK
Prizreni	14	5	BKUK
Ferizaj	7	12	BKUK
Gjithsej	235	32	/

tuar nga një projekt i fondacionit SOROS, përmes së cilit iu është mundësuar qasje në internet këtyre bibliotekave. Por edhe ky projekt duket se është i përkohshëm. BKUK-ja ka brezin tejet të limituar të qasjes në internet.

Materialet bibliotekare shfrytëzohen sipas meto-dave të vjetra. Nuk është bërë ndonjë investim i caktuar në fushë të përmirësimit të teknologjisë dhe të standard-eve bashkëkohore për përdorimin e materialeve bibliotekare.

Për shkak të vjedhjes, dëmtimit ose keqadministrimit,

koleksione të çmueshme të bibliotekave në Kosovë mungojnë. BKUK-ja është në fazën e përfundimit të revizionit. Një *Desideratum list*, i cili do të formohet në fund, do t'i dorëzohet Shërbimit të Bibliografisë për plotësim e pastaj edhe Shërbimit të Pasurimit, në mënyrë që fondet e rëndësishme që mungojnë, por që mund të gjenden në treg ose te njerëzit e ndryshëm (për këtë qëllim do të bëhet thirrje publike, ose do të angazhohet ndonjë agjent libri), të cilët janë të gatshëm t'ia dhurojnë ose t'ia shesin ato fonde BKUK-së, të rikompensohen.

Numri i titujve nuk korrespondon me vlerën e tyre. Shumë prej fondeve nëpër bibliotekat e Kosovës ekzistojnë në më shumë ekzemplar dhe janë të ngjyrosura ideologjikisht, prandaj shumë sosh janë të papërdorshme në shumë kopje. Rrjedhimisht, bibliotekat në Kosovë nuk mund të ofrojnë qasje të plotë për përdoruesit në aktivitetin kreativ dhe atë intelektual, e as në krijimin e mundësive të plota individuale për lirinë e shprehjes.

Ende nuk janë krijuar mundësi që stafi bibliotekar dhe përdoruesit e saj të kenë **qasje të drejtpërdrejtë në materialet bibliotekare.** Përdorimi i tyre është sporadik për shkak të mungesës së katalogut të

BIBLIOTEKAT ME FONDE TË HAPURA NË KOSOVË

Komuna	Biblioteka	Fonde të hapura	Sektori
Prishtina			
Mitrovica		Një (1)	Sek. i fëmijëve
Gjilani		/	
Peja		/	
Gjakova		Një (1)	Sek. i fëmijëve
Prizreni		Një (1)	Sek. i fëmijëve
Ferizaj		Një (1)	Sek. i fëmijëve
Deçan		Një (1)	Sek. i fëmijëve

përgjithshëm elektronik të bibliotekave në Kosovë, qendër e të cilit duhet të jetë Biblioteka Kombëtare e Kosovës, e cila në të njëjtën kohë, me ligj, duhet të mbikëqyrë krijimin e rrjetit të përbashkët të bibliotekave në Kosovë.

Për shkak të shkëputjeve të mëdha, bibliotekat nuk kanë mundësi që të garantojnë mbledhjen dhe ruajtjen e të gjitha llojeve të materialeve bibliotekare të cilat do të pasqyrojnë diversitetin kulturor ose do t'u shërbenin grupeve të caktuara sociale. Sidomos, mungojnë format e reja të materialeve bibliotekare, të cilat do t'i shërbenin krijimit të pavarur dhe edukimit individual. Rrjedhimisht, ato nuk mund të stimulojnë plotësisht krijimin e **vendimmarrjes së lirë**.

Infrastruktura e bibliotekave (pjesa dërrmuese e godinave të bibliotekave në Kosovë janë adaptuar për përdorim bibliotekar, prandaj destinacioni i tyre i tyre nuk ka qenë biblioteka) dhe statusi i tyre i pazgjydhur ndonjëherë (disa biblioteka të cilat financohen me mjete publike vazhdojnë të bashkëjetojnë në kuadër të Shtëpive të kulturës) e pamundëson krijimin e bibliotekave të tipit të hapur. Qasja e përdoruesve në fondet bibliotekare është e kufizuar.

Para një kohe, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Kuvendin e Kosovës *Aktin e Mirëkuptimit për Qendrën Informativë të BKUK-së për Qeverisjen Parlamentare* (Shih shtojcën 4). Përmes kësaj qendre, përdoruesve të bibliotekave në Kosovë dhe opinionit kosovar i është mundësuar qasje e lirë në arkivin elektronik të Kuvendit të Kosovës. Përdoruesit e BKUK-së do të kenë qasje të menjëhershme në të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit të Kosovës, duke e realizuar një të drejtë themelore të tyre për qasje në informata zyrtare dhe për krijimin e pavarur të opinionit për punën e këtij kuvendi. Bibliotekat publike në Kosovë, të cilat kanë përgjegjësi para përdoruesve të tyre, në kuptimin e ofrimit të shërbimeve,

duhet të synojnë njohjen me këto praktika, në mënyrë që të gjithë përdoruesve të tyre t'iu ofrojnë qasje në informatat zyrtare.

III. BIBLIOTEKAT NË KOSOVË DHE INTERNETI

Zhvillimi i teknologjive të reja informative ka ndryshuar rrënjësisht formën e ofrimit të qasjes në informata. Sot, bibliotekat ofrojnë shërbimet e tyre përmes teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, duke përbushur kërkesën për qasje të lirë në katalogun elektronik edhe nga shtëpia, ose për të porositur materiale bibliotekare nga distanca. Ndryshimi i ofrimit të shërbimeve në biblioteka ka kushtëzuar edhe hartimin e legjislacionit të nevojshëm për të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë në internet, si dhe hartimin e politikave të veçanta për zhvillimin e Teknologjive Informative

(TI-ve) dhe aplikimin e tyre në biblioteka.

Shteti duhet të garantojë me ligj të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë në informata përmes internetit. Në Danimarkë, p.sh., e drejta e qasjes së lirë në internet është e rregulluar me *Ligjin për Biblioteka*, dhe zhvillohet konform politikave të shtetit për zgjerimin e Teknologjive Informative (TI). Sipas këtij ligji, qytetari danez ka të drejtë të ketë qasje të lirë në internet, kurse bibliotekat janë burim i rëndësishëm për përpjekjet e qeverisë për zhvillimin rrjetit për të gjithë qytetarët e saj.²

Kosova nuk ka pasur deri vonë ndonjë politikë të veçantë për zhvillimin e TI-ve. Më 3 mars të vitit 2003 Ministria e Shërbimeve Publike ka shpallur draftin e parë (i cili pritet të modifikohet) të Strategjisë për Zhvillimin e Teknologjive Informative në Kosovë³ (TIK), i cili paraqet pikësynimet për përvijimin e një strategjie për shtrirjen e tyre në Qeverinë e Kosovës. Njëra nga katër synimet e kësaj strategjie është “qasja dhe shkëmbimi i informatave”, me të cilën parashihet ngritja e nivelit të qasjes në informata (dokumente zyrtare etj.), si dhe në shkëmbimin e lehtë dhe të papenguar të këtyre informatave. Po ashtu, më këtë

² Rikke Frank Jørgensen, *Interneti dhe Lira e të Shprehurit*, fq.60.

³ *Teknologjia Informative në Qeverinë e Kosovës- Plani i veprimit*, MPS/DIT/20030303001, dt.03.03.2003. .

strategji parashihet dhe “ngritja e kapaciteteve (resurseve humane) për përdorimin e teknologjive të reja informative, me të cilin do të sigurohet një politikë e qëndrueshme shtetërore në krijimin dhe ruajtjen e resurseve njerëzore, të afta për të aplikuar në praktikë teknologjitë më të reja informative, përmes një “politike agresive të trajnimit”.⁴

E drejta për qasje në burimet globale të informacionit duhet të jetë e garantuar me ligjishtetimin për bibliotekat, sepse bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë porta esenciale të internetit, prandaj ofrimi i qasjes në internet nëpër biblioteka është esencial, sidomos për ato kategori të përdoruesve të cilave biblioteka u shërben si portë e vetme për të marrë informacione globale, ose për t’i paraqitur interesat, njohuritë dhe kulturën e tyre para tërë botës. Në vendet me politika të zhvilluara sociale qasja në internet është e pakufizuar për të gjithë qytetarët. Kështu, për shembull, biblioteka “Pompidu” e Parisit ka krijuar një hallkë lidhëse (link) me qendrat për punësim, baza e të cilave konsultohet drejtpërdrejt nga përdoruesit e bibliotekës. Por, ekzistojnë vende në të cilat janë bërë shumë kufizime të kësaj të drejte. Në Kubë, për shembull, gjatë vitit 2003 janë marrë një varg masash për pengimin e qasjes në internet.⁵

⁴ Po aty.

⁵ Të dhënat i referohen faqes zyrtare të ALA-s (American Library Association).

QASJET NË INTERNET NË BIBLIOTEKAT E KOSOVËS

Komuna	Biblioteka	Poseidon	Qas. në internet
Prishtina	BKUK	PO	50
Prishtina	“H.Sulejmani”	PO	/
Mitrovica	“L. Berisha”	PO	/
Gjakova	“ “	PO	/
Prizreni		PO	/
Ferizaj		PO	/
Gjilani	“Fan Noli”	Jo	
Peja	“A. Shkreli”	Jo	
Vushtrria		Jo	/
Skenderaj		Jo	/
Drenas		Jo	/
Klinë		Jo	/
Isotg		Jo	/
Dragash		Jo	/
Shterpcë		Jo	/
Shtime		Jo	/
Kaçanik		Jo	/
Viti		Jo	/
Besian		Jo	/
Leposaviq		?	?
Zubin Potok		?	
Artanë		Jo	/
Fushë Kosovë		Jo	/
Kastriot		Jo	/

Sidoqoftë, interneti paraqet jo vetëm mundësi për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare, por edhe portë esenciale për qasje në informata. Ai shërben si medium i fuqishëm për të thithur informata globale, pa marrë parasysh kufijt. Në Ligjin për Bibliotekat, të miratuar më 2003 nga Kuvendi i Kosovës, nuk gjendet asnjë nen që e përcakton këtë të drejtë. Asnjëra nga bibliotekat publike në Kosovë nuk posedon me bazën e plotë të të dhënave ose me katalog elektronik. Kërkimi dhe ofrimi i informatave bëhet ende në mënyrë manuale, kurse shërbimet janë të kufizuara. Në prill të vitit 2004, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar kontratë me kompaninë izraelite “Ex’ Libris” për ta instaluar Sistemin e Integruar Bibliotekar “Aleph 500”, me të cilin do të krijohet hallka e parë e rrjetit të bibliotekave në Kosovë, e me këtë do të përmirësohen dukshëm shërbimet bibliotekare dhe mundësitë e qytetarëve të Kosovës për të pasur qasje të lirë në informata përmes internetit. Por, krijimit të rrjetit bibliotekar do të duhej t’i paraprinin disa veprime paraprake:

- hartimi i Ligjit për Qasje në Internet;
- hartimi i politikave për zhillimin e teknologjisë informative në biblioteka në harmoni me

strategjinë e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e teknologjive të reja informative në vend;

- plotësimi i legjislacionit për bibliotekat, në mënyrë që të garantohet zbatimi i shërbimeve përmes teknologjive të reja informative, etj.

Hapi i parë në garantimin e së drejtës së individit për qasje në internet në Evropë është ndërmarrë më 1994, kur Komisioni Evropian hartoi raportin “Bangeman”, i cili u shndërrua në plan për krijimin e një shoqërie globale të informacionit.⁶ Në bazë të këtyre politikave, vende të veçanta hartuan strategji për zhvillimin e TI-ve, ndërsa bibliotekat e përkrahën përfshirjen e tyre në shërbimet bibliotekare. Në fakt, aplikimi i teknologjive të reja në biblioteka ka filluar shumë më herët, më 1963,⁷ kurse aplikimi i internetit në vitet '90 e transformoi përfundimisht konceptin për bibliotekat, të cilat u orientuan drejt krijimit të bibliotekave digjitale. *Manifesti i IFLA-s për Internetin* parashihte që e drejta e qasjes në internet është e drejtë themelore e përdoruesve të bibliotekave, dhe bënte

⁶ Ioannis Trohopoulos, *Shërbimet e reja bibliotekare: aksesit i komunitetit në Internet*, “Bibliothecae 3”, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Tiranë, 2002, fq.86.

⁷ Sally McCallum, *40 Years of Technology in Libraries: A Brief History of the IFLA Section on Information Tehnology, 1963/64-2003*, July 2003.

thirrje për të pamundësuar censurimin e saj për shkaqe ideologjike, politike a religjioze, ose për shkak të barrierave ekonomike. Mirëpo, ky manifest njihte edhe të drejtën e stafit bibliotekar për të udhëzuar përdoruesit vetëm për përdorimin e informacionit cilësor, jofyës, në internet. Përvoja e vendeve të zhvilluara ka treguar se aplikimi i teknologjive të reja informative krahas përparësive të mëdha që ka ofruar në përmirësimin e shërbimeve bibliotekare, ka ngritur edhe shumë dilema përsa i përket të drejtës së përdoruesve të këtyre bibliotekave për qasje në materialet elektronike. Ta zëmë, është ende e papërcaktuar nëse garantimi i të drejtës për qasje të lirë në internet nënkupton se ai (përdoruesi) mund të ketë qasje në të gjitha informtatat që ofrohen në internet. Cilat janë të drejtat e bibliotekave në përzgjedhjen e materialeve që do t'i ofrohen qytetarëve? Dhe, së fundi, a mund të jenë pjesë e kësaj të drejte materialet pornografike ose violente? Garantimi i së drejtës së qasjes së lirë në informata përmes internetit do të duhej të kuptohej jo vetëm si përcaktim i së drejtës së qytetarit për qasje të lirë në internet, por edhe i së drejtës së bibliotekave për të zgjedhur materialin që do t'u ofrohet përdoruesve, në kuptimin e statusit të atij materiali. Pornografia nuk mund të jetë material i përdorshëm dhe bibliotekat kanë të drejtë të pakon-

testueshme që këto materiale të mos i ofrojnë për shfrytëzim për përdoruesit.

Në shumë vende të botës bibliotekat kanë qenë të detyruara të krijojnë “teknologjinë filtruese” (edhe pse kjo ndonjëherë ka qenë kontestuar me gjyq, madje është quajtur edhe si shkelje e të drejtës së qytetarëve për të pasur qasje në *diversitetin e shprehjes*) për të pamundësuar që, fëmijët ta zëmë, në bibliotekat publike të kenë qasje në Web faqet me përmbajtje pornografike.

Cili është roli i bibliotekave në krijimin e mundësive për qasje të lirë në informatat globale dhe në ekspozimin para botës të krijimtarisë personale? Mendoj se zhvillimet nëpër biblioteka karshi teknologjive të reja informative do të orientohen në dy drejtime themelore:

- krijimin e qasjes së lirë në informata përmes internetit
- aftësimin e përdoruesve për përdorimin e këtyre teknologjive

Përsa i përket çështjes së parë, krijimit të qasjes së lirë për të gjithë qytetarët në informata përmes teknologjive të reja, bibliotekat do të vazhdojnë të përballen me dilemën e madhe: çfarë nënkuptohet me qasje të lirë. A do të thotë kjo se të gjitha materialet duhet të lejohen të përdoren në biblioteka, apo duhet që ato të përdorin “teknologjinë filtruese” për të paran-

daluar qasjen në informatat e dëmshme? Kjo do të mbetet preokupim i vazhdueshëm i bibliotekave.

Sa i përket aftësimin të përdoruesve për përdorimin e këtyre teknologjive në biblioteka, mendoj se bibliotekat, konform strategjisë për zhvillimin e TI-ve, do të shndërrohen në qendra për aftësimin e përdoruesve për përdorimin e teknologjive informative, me qëllim të realizimit të kërkimeve të tyre shkencore ose sociale. Të mos harrojmë, kërkesat sociale (për punë, ta zëmë), tashmë kanë filluar që të shtrohen nga biblioteka, përmes qasjes së drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të qendrave për punësim. Po ashtu, bibliotekat dalëngadal po shndërrohen në qendra koordinuese përsa i përket informacionit qeveritar (kujto vendimin për hapjen e Qendrës Informative të BKUK-së për Qeverisjen Parlamentare, e cila ofron qasje të drejtpërdrejtë në arkivin elektronik të Kuvendit të Kosovës, si hapi i parë, konkret, në aplikimin e kësaj praktike në bibliotekat në Kosovë). Bibliotekat, sidomos ato publike, kanë për obligim që të kujdesen jo vetëm për sigurimin e informacioneve përmes internetit, por edhe aftësimin e përdoruesve në kërkimin dhe përdorimin e tyre përmes teknologjive të reja informative. Kërkesa për krijimin e rrjetit të bibliotekave, prandaj, është kërkesë në rritje dhe të gjitha bibliotekat duhet të men-

dojnë të inkuorohen në rrjet, me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave e cila garanton informacion të plotë për materialet bibliotekare, si dhe për qasje në dokumente të ndryshme përmes internetit. Po ashtu, ato duhet të hulumtojnë dhe të garantojnë shërbime profesionale përmes internetit, duke krijuar strategji për përparimin e shërbimeve bibliotekare. Vetëm kështu, ato do të realizojnë të drejtën elementare të çdo inividi për qasje të lirë në informata.

PËRFUNDIME

Liria intelektuale nënkupton të drejtën e çdo individi që të mbajë dhe të shprehë mendimin e tij, si dhe të japë ose të pranojë informata. Respektimi i kësaj të drejte në biblioteka duhet të kuptohet si shtysë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare, me qëllim të stimulimit të vlerave humane. Në këtë kuptim, bibliotekat mund të ndihmojnë shumë në respektimin e vlerave të përgjithshme njerëzore dhe në funksionimin e mirëfilltë të demokracisë. Nxitja e vendimmarjes së lirë dhe edukimi gjatë tërë jetës janë vetëm disa nga parimet të cilat bibliotekat duhet t'i respektojnë, për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie të shëndoshë.

Respektimi i këtyre të drejtave dhe ofrimi i shërbimeve cilësore bibliotekare duhet të çmohen si themel i demokracisë.

Bibliotekat në Kosovë, për shkak të mungesës së mundësive për shkollim profesional ose për shkak të rrethanave nëpër të cilat kanë kaluar, nuk kanë patur çdoherë mundësi që të ofrojnë shërbime cilësore profesionale, e aq më pak që ta stimulojnë qasjen e papënguar në informata ose vendimmarrjen e lirë. Duke patur një staf me përgatitje heterogjene profesionale, pastaj duke qenë të përjashtuar një kohë të gjatë nga bibliotekat, si dhe në pamundësi për të përcjellur në mënyrë të pashkëputur ndryshimet në konceptin bibliotekar, ato nuk kanë patur gjithmonë mundësi që t'i aplikojnë ndryshimet në konceptin dhe rolin e bibliotekave në ndërtimin e një demokracie të mirëfilitë, ose për t'i përshtatur këto koncepte në praktikën e tyre bibliotekare. Sot, bibliotekat në Kosovë kanë, mbase, përqindjen më të ulët të stafit të shkolluar në rajon, vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre i është nënshtruar çfarëdo formimi profesional, stafi i ri është po ashtu me përgatitje heterogjene dhe nuk i është nënshtruar trajnimeve të duhura profesionale. Vetë bibliotekat janë në fazën initiale të njohjes së teknologjive të reja informative, ndërkohë që katalogët e tyre vazhdojnë të përdoren në mënyrë manuale. Interneti, i domos-

doshëm për plasimin online të katalogut elektronik, ende nuk është aplikuar në shumicën e bibliotekave në Kosovë, ndërkohë që *Strategjia për Zhvillimin e TI*-ve parasheh krijimin e rrjetit vetëm në institucionet qeveritare- ministritë.

Pa u plotësuar këta parametra, bibliotekat në Kosovë nuk do të mundën t'i respektojnë parimet themelore të demokracisë, qasjen e lirë dhe të pakufizuar në informata.

Çfarë kërkohet në të ardhmen? Parasëgjithash, investim i shtetit në formimin profesional të bibliotekarëve sipas standardeve dhe normave ndërkombëtare; hartimi i strategjisë për zhvillimin e TI-ve në biblioteka; qasja e pakufizuar në informata, përmes katalogut të përgjithshëm elektronik; stimulimi i vendimmarrjes së lirë përmes ofrimit të mundësive për të zhvilluar aktivitete kulturore nëpër bibliotekat publike, ose përmes krijimit të mundësive për qasje të pakufizuar në informatat zyrtare, përmes krijimit të linkut me arkivat elektronike të institucioneve qeveritare etj. Krijimi i një stafi të formuar bibliotekar është mundësi e mirë për ndryshimin e pikëpamjes jo vetëm për format e ofrimit të shërbimeve, por edhe për transformimin e konceptit për vetë bibliotekat.

SHTOJCAT



Shtojca 1:

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 217 A (III) të 10 dhjetorit 1948.

Hyrje

Duke pasur parasysh se njohja e dinjitetit që u përket të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore si dhe njohja e të drejtave të tyre të barabarta e të patjetërsueshme përbën themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes në botë.

Duke pasur parasysh se mosnjohja dhe nëpërkëmbja e të drejtave të njeriut kanë çuar në akte barbarie që revoltojnë ndërgjegjen e njerëzimit dhe se krijimi i një bote ku qeniet njerëzore do të jenë të lira të flasin dhe të besojnë, të çliuar nga terrori dhe nga mjerimi, është shpallur si aspirata më e lartë e njeriut,

Duke pasur parasysh se është thelbësore që të drejtat e njeriut të mbrohen nga një regjim ku të sundojë ligji me qëllim që njeriu të mos jetë i shtrënguar të përdorë mjetin e fundit që është kryengritja kundër tiranisë dhe shtypjes,

Duke pasur parasysh se është thelbësore që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve,

Duke pasur parasysh se në Kartën populjt e Kombeve të Bashkuara kanë shpallur përsëri besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e qenies njerëzore, në barazinë e të drejtave të burrave dhe grave, dhe se janë deklaruar të vendosur për të favorizuar progresin shoqëror dhe për të krijuar kushte më të mira jetese në një liri më të madhe,

Duke pasur parasysh se Shtetet Anëtare janë angazhuar të sigurojnë, në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, respektimin universal dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore,

Duke pasur parasysh se një koncept i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive ka një rëndësi shumë të madhe për të përmbushur këtë angazhim,

Asambleja e Përgjithshme shpall këtë Deklaratë universale të të drejtave të njeriut si idealin e përbashkët që duhet të arrihet nga të gjithë popujt dhe të gjitha kombet me qëllim që të gjithë individët dhe të gjitha organet e shoqërisë, duke pasur përherë në mendje këtë Deklaratë, të përipiqen, nëpërmjet arsimit dhe edukimit, të zhvillojnë respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe të sigurojnë, me anë masash progresive të karakterik kombëtar dhe ndërkombëtar, njohjen dhe zbatimin e tyre universal dhe efektiv, si midis popujve të vetë Shteteve Anëtare, ashtu edhe midis popujve të territoreve që ndodhen në juridiksionin e tyre.

Neni 1

Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie.

Neni 2

1. Çdo njeri mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa

asnjë dallim, veçanërisht për nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinionio politik ose çdo opinion tjetër ose çdo situatë tjetër.

2. Veç asaj nuk do të bëhet asnjë dallim mbi bazën e statutit politik, juridik, apo ndërkombëtar të vendit ose territorit, shtetësinë e të cilit ka një person, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, nën kujdestari, jo autonom ose i kufizuar në ndonjë mënyrë në sovranitetin e tij.

Neni 3

Çdo njeri ka të drejtën e jetës, të lirisë dhe të sigurisë së personit të vet.

Neni 4

Askush nuk mund të mbahet në skllavëri apo në një formë tjetër nënshtrimi: skllavëria dhe tregëtia e skllërvë janë të ndaluara në çfarëdo lloj forme.

Neni 5

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese.

Neni 6

Çdo njeri ka të drejtën t'i njihet personaliteti juridik në çdo vend dhe në çdo rast.

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë pa dallim të kenë mbrojtje të barabartë nga ligji. Të gjithë kanë të drejtë të kenë një mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Neni 8

Çdo njeri ka të drejtën e një rekursi efektiv përpara juridiksioneve kombëtare kompetente për veprimet që shkelin të drejtat themelore që i njihen atij nga kushtetuta ose nga ligji.

Neni 9

Askush nuk mund të arrestohet, të burgoset as të dëbohet në mënyrë arbitrare.

Neni 10

Çdo njeri ka të drejtë, në barazi të plotë, që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi dhe publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e cila duhet të vendosë si përsa u përket të drejtave dhe detyrimeve të tij, ashtu dhe për themelsinë e çdo akuze në fushën penale

të drejtuar kundër tij.

Neni 11

1. Çdo njeri i akuzuar për një veprë keqbërëse prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të jetë provuar ligjërisht gjatë një procesi publik ku të jenë siguruar garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij.
2. Askush nuk mund të dënohet për veprime ose mosveprime, të cilat në kohën kur ato janë kryer, nuk përbënin një veprë keqbërëse sipas të drejtës së brendshme apo asaj ndërkombëtare. Po kështu nuk do të jepet asnjë dënim që të jetë më i rëndë se ai që zbatohet në kohën kur vepra keqbërëse është kryer.

Neni 12

Askush nuk mund të jetë objekt ndërhyrjesh arbitrare në jetën e tij private, në banesën ose letërkëmbimin e tij, as objekt cënimesh të nderit dhe të reputacionit të tij. Çdo person ka të drejtën të ketë mbrojtjen e ligjit kundër ndërhyrjeve të tilla ose cënimeve të tilla.

Neni 13

1. Çdo njeri ka të drejtë të qarkullojë lirisht dhe të zgjedhë vendbanimin e tij brenda një shteti.

2. Çdo njeri ka të drejtë të largohet nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e tij, si dhe të kthehet në vendin e tij.

Neni 14

1. Përballë persekutimit çdo njeri ka të drejtë të kërkojë strehim dhe të përfitojë strehim në vende të tjera.
2. Kjo e drejtë nuk mund të kërkohej në rastet kur përndjekja bazohet realisht në një krim ordiner ose në veprime që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

1. Çdo njeri ka të drejtën e një shtetësie.
2. Askush nuk mundet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij, as nga e drejta për të ndryshuar shtetësinë.

Neni 16

1. Duke filluar nga mosha e pjekurisë (age nubile), burri dhe gruaja kanë të drejtë, pa asnjë kufizim për nga raca, shtetësia apo feja të martohen dhe të krijojnë familje. Ata kanë të drejta të barabarta ndaj martesës, gjatë martesës dhe kur ajo prishet.

2. Martesa mund të kryhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.
3. Familja është njësisia e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe duhet të ketë mbrojtjen e shoqërisë dhe të shtetit.

Neni 17

1. Çdo njeri qoftë vetëm për vetëm apo bashkë me të tjerët ka të drejtën e pronës.
2. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga prona e tij.

Neni 18

Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet si dhe lirinë për të manifestuar fenë ose bindjet, vetëm për vetëm apo bashkërisht, si në publik ashtu dhe privatisht, nëpërmjet arsimit, praktikave, kultit të kryerjes së riteve.

Neni 19

Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë.

Neni 20

1. Çdo njeri ka të drejtën e lirisë për t'u mbledhur dhe për t'u bashkuar në organizata paqësore.
2. Askush nuk mund të detyrohet të bëjë pjesë në një organizatë.

Neni 21

1. Çdo njeri ka të drejtë të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike të vendit të vet, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirish.
2. Çdo njeri ka të drejtë të hyjë, në kushte barazie, në funksionet publike të vendit të vet.
3. Vullneti i popullit është themeli i autoritetit të pushtetit publik; ky vullnet duhet të shprehet përmes zgjedhjeve të lira që duhet të zhvillohen periodikisht me votim të përgjithshëm, të barabartë, të fshehtë ose sipas një procedure të barazvlefshme që të sigurojë lirinë e votës.

Neni 22

Çdo njeri, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtën e sigurimit shoqëror; ai ka të drejtë të presë që t'i plotësohen të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të domosdoshme për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të

personalitetit të tij nëpërmjet përpjekjeve brenda vendit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur parasysh organizimin dhe burimet e çdo vendi.

Neni 23

1. Çdo njeri ka të drejtën e punës, të zgjedhë lirisht punën e tij, të ketë kushte të përshtatshme dhe të kënaqshme pune si dhe të mbrohet nga papunësia.
2. Të gjithë kanë të drejtë, pa asnjë diskriminim, për një rrogë të barabartë për punë të barabartë.
3. Kushdo që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të kënaqshëm që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetesë, në përputhje me dinjitetin njerëzor dhe të plotësuar, po të jetë nevoja, me çfarëdo mjetesh të tjera të mbrojtjes sociale.
4. Çdo njeri ka të drejtë të themelojë me persona të tjerë sindikata ose të bashkohet me sindikata për mbrojtjen e interesave të tij.

Neni 24

Çdo njeri ka të drejtën e pushimit e të argëtimit dhe veçanërisht të drejtën për një kufizim të arsyeshëm të kohëzgjatjes së punës si dhe pushime periodike të paguara.

Neni 25

1. Çdo njeri ka të drejtën për një nivel jetese të mjaftueshëm për të siguruar shëndetin, mirëqenien e tij dhe të familjes, veçanërisht për ushqimin, veshjen, strehimin, trajtimin mjekësor si dhe për shërbimet sociale të nevojshme; ai ka të drejtën për sigurimet shoqërore në rast papunësie, sëmundjeje, invaliditeti, vetmie bashkëshortore, pleqërie apo raste të tjera kur ka humbur mjetet për të jetuar për shkak rrethanash që nuk varen nga vullneti i tij.
2. Nëna dhe fëmija kanë të drejtën për një ndihmë dhe një asistencë të posaçme. Të gjithë fëmijët, qofshin të lindur në martesë apo jashtë saj, gëzojnë mbrojtje shoqërore të njëjtë.

Neni 26

1. Çdo njeri ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të pakën përsa i përket arsimit fillor dhe themelor. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional do të jetë i përgjithësuar; hyrja në studimet e larta duhet të jetë e hapur në barazi të plotë për të gjithë sipas meritës së secilit.

2. Arsimi duhet të synojë lulëzimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe forcimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Ai duhet të favorizojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve raciale ose fetare si dhe të ndihmojë zhvillimin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.
3. Prindërit kanë të drejtën, në mënyrë prioritare, të zgjedhin llojin e arsimit për fëmijët e tyre.

Neni 27

1. Çdo njeri ka të drejtën të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të komunitetit, të gëzojë artet dhe të marrë pjesë në progresin shkencor dhe në të mirat që vijnë së andejmi.
2. Çdo njeri ka të drejtën e mbrojtjes së interesave morale e materiale që rrjedhin nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik, autor i të cilit ai është.

Neni 28

Çdo njeri ka të drejtën që, në planin shoqëror dhe në planin ndërkombëtar, të mbretërojë një rend i tillë ku të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë të mund të gjejnë realizim të plotë.

Neni 29

1. Çdo njeri ka detyra kundrejt komunitetit përderisa vetëm këtu është i mundshëm zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.
2. Në ushtrimin e të drejtave dhe në gëzimin e lirive të tij, çdo njeri u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe vetëm me qëllim që të sigurohen njohja dhe respektimi i të drejtave të tjetrit dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.
3. Këto të drejta dhe liri nuk mund të ushtrohen, në asnjë rast, në kundërshtim me qëllimet dhe me parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 30

Asnjë dispozitë e kësaj Deklarate nuk mund të interpretohet sikur nënkupton për një shtet, një grup ose një individ, çfarëdo të drejte për të zhvilluar një veprimtari ose shtet për të kryer një akt që synon shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të shpallura prej saj.



Shtojca 2:

DEKLARATA E GLAZGOUT MBI BIBLIOTEKAT, SHËRBIMET E INFORMACIONIT DHE LIRINË INTELEKTUALE

Në takimin në Glazgou, mbajtur me rastin e 75-vjetorit të formimit të saj, Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA) deklaroi se:

- IFLA shpall të drejtën fundamentale të qenieve njerëzore për qasje dhe shprehje të informacionit pa kufizim.
- IFLA dhe mbështetja nga anëtarësia nga mbarë

bota, mbrojnë dhe promovojnë lirinë intelektuale, siç është shprehur në Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë intelektuale përfshinë begatinë e njohurisë njerëzore, opinionin, mendimin krijues dhe veprimtarinë intelektuale.

- IFLA konfirmon se përkushtimi ndaj lirisë intelektuale është përgjegjësi kyçe e bibliotekave dhe profesionit të informacionit në mbarë botën, e shprehur përmes kodeve morale dhe e demonstruar përmes praktikës.

IFLA konfirmon se:

- Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë qasje në informacion, ide dhe punën imagjinative në çdo medium, pa marrë parasysh kufijtë. Ato shërbejnë si porta të njohurisë, mendimit dhe kulturës, duke ofruar mbështetje esenciale për vendimmarrje të pavarur, zhvillim kulturor, hulumtim dhe studim jetësor, si nga individë ashtu dhe nga grupe.
- Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit do të marrin, ruajnë dhe do të ofrojnë shumëllojshmëri të gjerë materialesh, duke reflektuar kështu pluralitetin dhe diversitetin në shoqëri. Përzgjedhja dhe sigurimi i materialeve dhe shërbimeve bib-

liotekare duhet të udhëhiqet nga konsiderata profesionale dhe jo nga pikëpamje politike, morale dhe fetare.

- Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit do t'i vënë materialet, pajisjet dhe shërbimet në dispozicion për të gjithë shfrytëzuesit. Nuk do të ketë diskriminim për çfarëdo arsye, përfshirë racën, origjinën kombëtare a etnike, gjininë a preferencën seksuale, moshën, paaftësinë, fenë, apo besimin politik.
- Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit do të mbrojnë të drejtën e secilit shfrytëzues për intimitet dhe konfidencialitet sa i përket informacionit të kërkuar apo të marrë dhe burimeve të konsultuara, huazuara apo të transmetuara.
- IFLA prandaj thërret bibliotekat dhe shërbimet e informacionit dhe stafet e tyre të kultivojnë dhe promovojnë parimet e lirisë intelektuale dhe të ofrojnë qasje të papenguar ndaj informacionit.

Kjo Deklaratë u përgatit nga IFLA/FAIFE.

Miratuar nga Bordi Udhëheqës i IFLA-s, 27 mars 2002, Hagë, Holandë. Shpallur nga Këshilli i IFLA-s, më 19 gusht 2002, në Gllazgou, Skotlandë.



Shtojca 3:

MANIFESTI I IFLA-S PËR INTERNETIN

Qasja e papenguar ndaj informacionit është esen-
cial për lirinë, barazinë, mirëkuptimin dhe paqen glob-
ale. Prandaj, Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve
Bibliotekare (IFLA) konfirmon se:

Liria intelektuale është e drejtë e çdo individi për të
mbajtur dhe shprehur mendimet dhe për të kërkuar e
për të marrë informacion; dhe kjo është në thelbin e
shërbimit bibliotekar.

Liria e qasjes ndaj informacionit, pa marrë

parasysh mediumin dhe kufijtë, është përgjegjësi qendrore e bibliotekës dhe profesionit informativ.

Provizioni i qasjes së papenguar në internet nga ana e bibliotekave dhe shërbimeve të informacionit mbështetë komunitetet dhe individët për të arritur lirinë, prosperitetin dhe zhvillimin.

Barrierat ndaj rrjedhës së informacionit duhet hequr, sidomos ato që promovojnë pabarazi, varfëri dhe dëshprim.

Liria e qasjes ndaj informacionit, Internetit dhe bibliotekave e shërbimeve të informacionit

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit janë institucione të gjalla që lidhin njerëzit me burime globale informacioni dhe me idetë dhe punën krijuese që kërkojnë ato. Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë begatinë e shprehjes njerëzore dhe diversitetin kulturor në të gjitha mediat.

Interneti global u mundëson individëve dhe komuniteteve anëmbanë botës, qofshin ato edhe në fshatrat më të vegjël dhe më të largët apo qytetet më të mëdha, për të pasur qasje të barabartë të informacionit për zhvillimin, edukimin, stimulimin, pasurimin kulturor, veprimtarinë ekonomike të individit dhe pjesëmarrjen

e informuar në demokraci. Të gjithë mund t'i paraqesin interesat e tyre, njohuritë dhe kulturën para tërë botës.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit ofrojnë porta esenciale të Internetit. Për disa ato ofrojnë lehtësi, udhëzim dhe asistencë, derisa për të tjerët ato janë pikat e vetme të mundshme të qasjes. Ato ofrojnë një mekanizëm për të kapërcyer barrierat e dallimeve në resurse, teknologji dhe trainim.

Parimet e lirisë së qasjes ndaj informacionit përmes Internetit

Qasja në Internet dhe të gjitha resurset e tij duhet të jenë në pajtim me Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut, posaçërisht të nenit 19:

Secili ka të drejtë për liri mendimi dhe shprehje; kjo e drejtë përfshinë edhe lirinë për të mbajtur opinione pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, pranuar dhe për të dhënë informacion dhe ide përmes medias pa marrë parasysh kufijtë.

Ndërlidhshmëria globale e Internetit ofron një medium përmes të cilit kjo e drejtë mund të gëzohet nga të gjithë. Rrjedhimisht, qasja nuk duhet t'i shtrahet

as ndonjë formë të censurës ideologjike, politike a religjioze, e as barrierave ekonomike.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit kanë gjithashtu përgjegjësi për t'u shërbyer të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve të tyre, pa marrë parasysh moshën, racën, kombësinë, religjionin, kulturën, përkatësinë politike, të metat fizike apo të tjera, gjininë apo orinetimin seksual, apo çfarëdo statusi tjetër.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit duhet të mbështesin të drjtën e shfrytëzuesve për të kërkuar informacionin e zgjedhjes së tyre.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit duhet të respektojnë intimitetin e shfrytëzuesve të tyre dhe të njohin faktin se resurset që i përdorin ata duhet të mbeten konfidenciale.

Bibliotekat dhe shërbimet e informacionit kanë përgjegjësi për të siguruar dhe promovuar qasjen publike ndaj informacionit dhe komunikimit cilësor. Shfrytëzuesit duhet asistuar me aftësitë e domosdoshme dhe me një mjedis të përshtatshëm në të cilin do të përdorin burimet dhe shërbimet e zgjedhura të informacionit në mënyrë të lirë dhe konfidenciale.

Përpos shumë resurseve të vlefshme që ofron Interneti, disa janë jokorrekte, mashtruese dhe mund të jenë fyese. Bibliotekarët duhet të ofrojnë atë informacion dhe burime për shfrytëzuesit e bibliotekave për t'i

mësuar se si duhet përdorur Internetin dhe informacionin elektronik në mënyrë efikase dhe efektive. Ata duhet të promovojnë dhe të ofrojnë proaktivisht qasje me përgjegjësi ndaj informacionit të rrjetëzuar cilësor për të gjithë shfrytëzuesit, përfshirë fëmijët dhe të rinjtë.

Bashkërisht me të gjitha shërbimet elementare, qasja në Internet në biblioteka dhe shërbimet e informacionit duhet të jetë falas.

Implementimi i Manifestit

IFLA inkurajon bashkësinë ndërkombëtare të mbështesë zhvillimin e qasjes përmes Internetit anëmbanë botës, posaçërisht në vendet në zhvillim, për të arritur kështu përparësitë globale të informacionit për të gjithë atyre që u ofrohet përmes Internetit.

IFLA inkurajon qeveritë kombëtare për të krijuar një infrastrukturë kombëtare të informacionit, e cila do të ofrojë qasje Interneti për tërë popullsinë e një vendi.

IFLA inkurajon të gjitha qeveritë që të mbështesin rrjedhën e papenguar të qasjes së informacionit përmes Internetit, përmes bibliotekave dhe shërbimeve të informacionit dhe që t'i kundërvihen çfarëdo përpjekjeje për të censuruar dhe penguar qasjen.

IFLA inkurajon komunitetin bibliotekar dhe vendimmarrësit në nivele kombëtare dhe lokale të zhvillojnë strategji, politika dhe plane që implementojnë parimet e shprehura në këtë Manifest.

Shtojca 4:

AKT MIRËKUPTIMI (AMK)

ndërmjet UNDP-Kosovë/ Kuvendit të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Qendra Informative e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për Qeverisjen Parlamentare

Ky Akt Mirëkuptimi - AMK përcakton rolet dhe përgjegjësitë e UNDP-Kosovë/ Unionit Ndërparlamentar, projekti SPEAK, në mbështetje të Kuvendit të Kosovës në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës dhe me

Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK) për Qendrën Informative. Qendra do të formohet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Synimi parësor i Qendrës Informative të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për Qeverisjen Parlamentare është që t'i mundësojë publikut kosovar në përgjithësi të ketë shikim në përgjegjësinë dhe në dukshmërinë (transparencën) parlamentare.

Detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës palë janë të përcaktuara në Shtojcën 1 shoqëruese.

Është e kuptueshme që BKUK-ja do të ketë përdorim të plotë të kompjuterëve pas orarit të rregullt të punës.

Pas një viti kompjuterët, tavolinat dhe karriget do të jenë pronë e BKUK-së.

Ky AMK paraqet marrëveshjen e tërësishme ndër-mjet të UNDP-Kosovë/Kuvendit të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe nuk mund të hedhet poshtë, të ndryshohet apo të shfuqizohet, përveç se në formë të shkruar e të nënshkruar nga të gjitha palët. Asnjë përfaqësim apo kushtëzim nuk mund të bëhet nga asnjëra palë, përveç asaj që është thënë në këtë AMK. Kjo marrëveshje duhet të interpretohet në pajtim me ligjet në Kosovë dhe në Komunën e Prishtinës.

Shtojca 5:

LIGJI PËR BIBLIOTEKAT NË KOSOVË (KREU VI)

FUNKSIONET THEMELORE TE BIBLIOTEKAVE TE SEKTORIT PUBLIK

Neni 21

21.1. Bibliotekat publike në kuadër të funksionit të përgjithshëm nga neni 2 i këtij ligji, veçanërisht:

21.1.1. sigurojnë koleksione nga të gjitha kategorit e materialeve, në të gjitha formatet e mundshme

dhe në sasi të mjaftueshme si dhe informacione për të gjitha llojet e njohurive që reflektojnë drejtimet aktuale dhe zhvillimin e shoqërisë si dhe trashëgiminë krijuese botërore, duke përfshirë edhe atë të komunitetit, me qëllim që shfrytëzuesit të njohin trashëgiminë kulturore, vlerat e artit, arrijtet shkencore dhe zhvillimet e reja si dhe të plotësojnë nevojat e tyre për edukim, zhvillim personal, përfshirë edhe çlodhjen e argëtimit;

21.1.2. ruajnë dhe prezantojnë koleksionimin e trashëgimisë kulturore të bashkësisë në të gjithë larminë e saj;

21.1.3. mbledhin informacione rreth komunitetit dhe e bëjnë të përdorshëm, në mënyrë që të ndihmohen qytetarët për të ushtruar të drejtat e tyre demokratike, për t'u njohur me çështjet e aktivitetet themelore në komunitet dhe për vendmarrje të pavarur;

21.1.4. sigurojnë materiale e informacione që mbështesin arsimin e organizuar dhe arsimin individual të shfrytëzuesve të të gjitha moshave dhe që plotësojnë shërbimet e bibliotekave shkollore;

21.1.5. zhvillojnë veprimtari kulturore-sociale e edukuese për popullarizimin e librit dhe nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

21.2. Ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët në kushte të barabarta dhe pa asnjë dallim, si në bibliotekë edhe në bashkësi; sigurojnë qasje në informacion në të gjitha nivelet dhe trajnojnë shfrytëzuesit e të gjitha moshave në shfrytëzimin e informacionit dhe teknologjisë përkatëse; krijojnë mundësi për të pa aftët që të kenë qasje në mënyrë të pavarur; sigurojnë qasje të barabartë për shfrytëzuesit të cilët, për çfare arsye, nuk mund të përdorin shërbimet e zakonshme të bibliotekës (duke organizuar biblioteka lëvizëse për t'u shërbyar atyre që jetojnë në mjedise rurale, shërbime në shtëpi për ata që nuk mund të lëvizin nga shtëpia, shërbime për ata që janë në spitalë dhe burgje, materiale braile për të verbërit dhe regjistrime zanore për të shurdhërit).

Neni 22

Biblioteka Kombëtare e Kosovës

22.1. Biblioteka Kombëtare e Kosovës është institucioni bibliotekar qendror i Kosovës, dhe qendër e informacionit bibliotekar në nivel kombëtar.

22.1.a. Biblioteka Kombëtare e Kosovës themelohet me vendim të Kuvendit të Kosovës.

22.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është nën autoritetin e Ministrisë së Kulturës;

22.3. Biblioteka Kombëtare e Kosovës:

22.3.1. është qendër e marrjes dhe e depozitimit të kopjes së detyrueshme;

22.3.2. është qendër e krijimit dhe e mirëmbajtjes së katalogut përmbledhës kombëtar, respektivisht të bazës përmbledhëse kombëtare të të dhënave;

22.3.3. është qendër e studimeve në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë dhe të informacionit;

22.3.4. është qendër e përgatitjes dhe e ofrimit të informacionit bibliografik, bartëse e kontrollit bibliografik në bibliotekat e tjera dhe botuese e bibliografisë kombëtare;

22.3.5. është qendër metodike për zbatimin e standardeve dhe të rekomandimeve të organizatave dhe organizmave përkatës ndërkombëtar në veprimtarinë bibliotekare dhe të informacionit bibliotekar;

22.3.6. është qendër për restaurimin dhe konservimin e librit;

22.3.7. është qendër për koordinimin e rrjetit kombëtar bibliotekar;

22.3.8. vepron si qendër e huazimit ndërbibliotekar;

22.3.9. katalogon publikacionin e përgatitur për botim (CIP) dhe bën pajisjen e publikacioneve me numrat standard ndërkombëtarë (ISBN dhe ISMN) të botuesve në Kosovë;

22.3.10. Zhvillon programe për trajnimin dhe aftësimin profesional e të vazhdueshëm të punonjësve bibliotekar;

22.3.11. plotëson shërbimet e bibliotekave ndërkomunale dhe të Bibliotekës Universitare ;

22.3.12. ushtron mbikëqyrjen profesionale ndaj të gjitha bibliotekave;

22.4. Biblioteka Kombëtare e Kosovës anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare dhe merr pjesë në aktivitete bibliotekare ndërkombëtare.

22.4.1 Selia e Bibliotekës Kombëtare është në Prishtinë.

Neni 23

Bibliotekat komunale dhe ndërkomunale

23.1. Biblioteka ndërkomunale koordinon bashkëpunimin e dy ose më shumë bibliotekave komunale, ndihmon dhe plotëson veprimtarinë e tyre me koleksione, huazime, falje të materialeve bibliotekare dhe në shërbime të veçanta për shfrytëzuesit që nuk

kanë mundësi të shfrytëzojnë shërbimet e zakonshme.

23.2. Ministria e Kulturës themelon me vendim të veçantë bibliotekat ndërkomunale.

23.3. Ministria e Kulturës, në marrëveshje me organet përkatëse komunale, cakton bibliotekën që do të kryejë funksionin e bibliotekës ndërkomunale.

Neni 24

24.1. Biblioteka komunale krijohet në çdo komunë, si bibliotekë e bashkësisë në tërësi.

24.2. Bibliotekat komunale mund të themelojnë degët e tyre në lokalitete sipas kërkesave dhe mundësive buxhetore.

Neni 25

Biblioteka Universitare

25.1. Biblioteka Universitare është bibliotekë qendrore e Universitetit të Prishtinës.

25.2. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Universitare është nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me Universitetin.

25.3. Biblioteka Universitare siguron materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare që ndihmojnë veprimtarinë akademike e shkencore si dhe procesin e edukimit shkencor e artistik në Universitet dhe zhvillimin e aftësive të studentëve dhe mësimeve të tyre;

25.4. Ndhmon studentet që ndjekin studimet në distancë duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit.

25.5. Plotëson shërbimet e bibliotekave të fakulteteve në përbërjen e Universitetit.

25.6. Selia e Bibliotekës së Universitetit është në Prishtinë.

Neni 26

Bibliotekat e Institucioneve të shkollimit të lartë janë degë të Bibliotekës Universitare dhe sigurojnë materiale, informacione e shërbime bibliotekare që

ndihmojnë procesin e edukimit shkencor e artistik që ofron fakulteti si dhe zhvillimin e aftësive të studentëve dhe të mësimeve të tyre; ndihmon studentët që ndjekin studimet në distancë duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit.

Neni 27

Bibliotekat shkollore

27.1. Biblioteka shkollore vepron pranë institucionit arsimor përkatës.

27.2. Biblioteka shkollore siguron materiale, informacione e shërbime bibliotekare në funksion të edukimit që ofron shkolla dhe të zhvillimit të aftësive të nxënësve dhe të mësimeve të tyre.

Neni 28

Bibliotekat e veçanta

Bibliotekat e veçanta sigurojnë materiale, shërbime e informacione bibliotekare të llojit të veçantë të njohurive ose me tematikë të veçantë që i plotësojnë nevojat specifike të shfrytëzuesve dhe ndihmojnë e mbështesin aktivitetet e institucionit në përbërje të të cilit veprojnë.



BIBLIOGRAFIA:

<http://www.ifla.org>

<http://www.ifla.org/faife/index.htm>

http://www.osce.org/kosovo/human_rights/

<http://www.unhcr.org/>

<http://www.aslib.co.uk/>

<http://www.kb.dk/liber>

<http://www.amnesty.org/>

Library Bill of Rights <http://www.ala.org/ala/oif/statementspols/statementsif/librarybillrights.htm>

The Next Frontier: “Intellectual Property” and Intellectual Freedom, <http://www.feoproject.org/commentaries/coloradointellprop.html>

The progress of science and useful arts”:
why copyright today threatens intellectual freedom
<http://www.fepproject.org/policyreports/copyright2dexsum.html>

<http://www.bcla.bc.ca/ifc/>

Intellectual Freedom and Censorship of the Internet
<http://www.tfn.net/www-menus/infreedom.html>

Intellectual Freedom Manual

<http://www.flalib.org/library/fla/ifmanual.htm>

USA Patriot Act & Intellectual Freedom

http://www.omjp.org/Patriot/PatriotActIntellectualFreedom_v3_document.html

Shërbimi i i bibliotekës publike, udhëzime të IFLA/
UNESCO-s për zhvillim, Tiranë, 2002

Vehbi Miftari

BIBLIOTEKAT NË KOSOVË
DHE QASJA NË INFORMATA

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës,
Prishtinë,
2004

Shtypi:

“Prograf”
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

021.1:007(496.51)

MIFTARI, Vehbi

Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata/Vehbi Miftari. -Prishtinë:[Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës], 2004 (Prishtinë: “Prograf”). -93 fq.; 21cm

Bibliografia: fq. 91-92. - Në kopertinë fotografia me shënime për autorin

ISBN 9951-13-007-0